



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

**LËNDA:** Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**NJOFTIMI I FITUESIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: **“Bajrami N”** sh.p.k me adresë: Rruga Elbasan - Xibrakë, NJ.A. Labinot - Fushë, km 13, Elbasan.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 68395-08-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstrukcion i konviktit (vajzave) "Ymer Tola" të shkollës pedagogjike”** me fond limit: **30,490,653** (tridhjetëmilion e katërqind e nëntëdhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, dhe me afat për kryerjen e punimeve **2 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “Leon Konstruksion” sh.p.k me Nipt: K 71820009 I**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **25.913.826,33** (njëzet e pesëmilion e nëntëqind e trembëdhjetëmijë e tetëqind e njëzet e gjashtë presje tridhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **31.096.591,60** (tridhjetë e njëmilion e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë) **lekë** (me tvsh).

## **2. “Colombo” sh.p.k me Nipt: J 82916489 E**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **20,393,577** (njëzetmilion e treqind e nëntëdhjetë e tremijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **24,472,292** (njëzet e katërmilion e katërqind e shtatëdhjetë e dymijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë** (me tvsh).

## **3. BOE “NG Structures” sh.p.k me Nipt: L 79326502 O & “Shëndelli” sh.p.k. me Nipt: K 07924803 N**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **22,083,333** (njëzet e dymilion e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **26,500,000** (njëzet e gjashtëmilion e pesëqindmijë) **lekë** (me tvsh).

## **4. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **26.765.732,7** (njëzet e gjashtëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tridhjetë e dy presje shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **32.118.879,2** (tridhjetë e dymilion e njëqind e tetëmbëdhjetëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje dy) **lekë** (me tvsh).

## **5. “Elda - VL” sh.p.k me Nipt: K 67106202 W**

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

- 1. BOE “NG Structures” sh.p.k me Nipt: L 79326502 O & “Shëndelli” sh.p.k. me Nipt: K 07924803 N**
- 2. Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k me Nipt K 71820009 I**
- 3. Operatori ekonomik “Elda - VL” sh.p.k me Nipt K 67106202 W**
- 4. Operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k me Nipt: J 82916489 E**

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. BOE “NG Structures” sh.p.k & “Shëndelli” sh.p.k skualifikohet për arsye se :**

**1.1 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.6 të kapacitetit teknik ku kërkohet :** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ( të vlefshme ) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si mëposhtë :

- **1 (një)** punonjës teknik ndertimi
- **1 (një)** punonjës hidraulik
- **1 (një)** punonjës elektrikist
- **1 (një)** punonjës murator/suvatues
- **1 (një)** punonjës hekurthyes
- **1 (një)** punonjës hidroizulues
- **1 (një)** punonjës bojaxhi
- **1 (një)** punonjës pllakashtrues
- **1 (një)** punonjës karpentier
- **2 (dy)** punonjës te pajisur me certifikate per punimet ne lartesi

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3(tre) muajt e fundit**.

Operatori Ekonomik “**NG Structures**” **sh.p.k** ka paraqitur dokumentacion të pasaktë pasi:

Punonjësit Fatjon Hoxha dhe Manushaqe Hysenaj janë deklaruar nga OE si karpentier, por bazuar në listëpagesat e shoqërisë të paraqitura në SPE për **3 muajt e fundit** si dhe bazuar në VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezultojnë se Fatjon Hoxha dhe Manushaqe Hysenaj të deklaruar si karpentier me kode respektive **2161.01 dhe 5329.03** figurojnë të jete arkitekt dhe sanitare.

Punonjësit Marko Bollano dhe Kleard Beqaj janë deklaruar nga OE si hidroizolues, por bazuar në listëpagesat e shoqërisë të paraqitura në SPE për **3 muajt e fundit** si dhe bazuar në VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezultojnë se Marko Bollano dhe Kleard Beqaj të deklaruar si hidroizolues me kode respektive **3112.07 dhe 2161.04** figurojnë të jete eskavatorist dhe projektues arkitek.

Punonjësi Ndue Vocaj është deklaruar nga OE si hekurthyes dhe njekohesisht dhe si bojaxhi duke mos qenë i qartë në punën që do të kryej, por bazuar në listëpagesat e shoqërisë të paraqitura në SPE për **3 muajt e fundit** si dhe bazuar në VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezultojnë se Ndue Vocaj i deklaruar njekohesisht si hekurthyes dhe si bojaxhi me të njëjtin kod **9622.01** figuron të jete punëtor krahu.

Punonjësi Ridian Isufi është deklaruar nga OE si murator, por bazuar në listëpagesat e shoqërisë të paraqitura në SPE për **3 muajt e fundit** si dhe bazuar në VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezultojnë se Ridian Isufi i deklaruar si murator me kod **7126.03** figuron të jete hidraulik.

**1.2 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.5 të kapacitetit teknik ku kërkohet:** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Elektronik

Në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet dy shoqërive "Ng Structures" sh.p.k. dhe "Shëndelli" sh.p.k., Nr 2275 Rep, datë 10.09.2020, përcaktohet se shoqëritë do të marrin përsipër kryerjen e çdo zëri preventivi në përqindjet 40% "Ng Structures" sh.p.k. dhe 60% "Shëndelli" sh.p.k.

Bazuar në nenin 74, pika 3 të VKM 914, 3: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Në përmbushje të këtij kriteri, OE "Ng Structures" sh.p.k., nuk ka në stafin e tij inxhinier elektronik.

**1.3 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.11 të kapacitetit teknik ku kërkohet:** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçensë "Për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve" që kanë ndikim në mjedis, (Kodi III.2.B), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit.

Në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet dy shoqërive "Ng Structures" sh.p.k. dhe "Shëndelli" sh.p.k., Nr 2275 Rep, datë 10.09.2020, përcaktohet se shoqëritë do të marrin përsipër kryerjen e çdo zëri preventivi në përqindjet 40% "Ng Structures" sh.p.k. dhe 60% "Shëndelli" sh.p.k.

Bazuar në nenin 74, pika 3 të VKM 914, 3: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Në përmbushje të këtij kriteri, OE "Ng Structures" sh.p.k., nuk ka paraqitur Liçensë "Për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve" (Kodi III.2.B), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit.

**1.4 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.12 të kapacitetit teknik ku kërkohet:** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore tipi C, (Kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, "Për stacionim transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet dy shoqërive "Ng Structures" sh.p.k. dhe "Shëndelli" sh.p.k., Nr 2275 Rep, datë 10.09.2020, përcaktohet se shoqëritë do të marrin përsipër kryerjen e çdo zëri preventivi në përqindjet 40% "Ng Structures" sh.p.k. dhe 60% "Shëndelli" sh.p.k.

Bazuar në nenin 74, pika 3 të VKM 914, 3: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Në përmbushje të këtij kriteri, OE "Ng Structures" sh.p.k., nuk ka paraqitur leje mjedisore tipi C, (Kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, "Për stacionim transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

**2. Operatori ekonomik "Leon Konstruksion" sh.p.k skualifikohet për arsye se:**

**2.1 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.6 të kapacitetit teknik ku kërkohet :** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ( të vlefshme ) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve , si mëposhtë :

- **1 (një)** punonjës teknik ndertimi
- **1 (një)** punonjës hidraulik
- **1 (një)** punonjës elektrikist
- **1 (një)** punonjës murator/suvatues
- **1 (një)** punonjës hekurthyes
- **1 (një)** punonjës hidroizulues
- **1 (një)** punonjës bojaxhi
- **1 (një)** punonjës pllakashtrues
- **1 (një)** punonjës karpentier
- **2 (dy)** punonjës të pajisur me certifikate për punimet në lartësi

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3(tre) muajt e fundit**.

Operatori Ekonomik ka paraqitur dokumentacion të pasaktë pasi:

Punonjësit Gentjan Molla dhe Rozart Çallari janë deklaruar nga OE si hekurthyes, por bazuar në listëpagesat e shoqërisë të paraqitura në SPE për 3 **muajt e fundit** si dhe bazuar në VKM nr 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezultojnë se Gentjan Molla dhe Rozart Çallari

te deklaruar si hekurthyes me kode respektive **7123.03 dhe 7212.09** figurojnë te jete suvatues dhe saldator.

Punonjësi Hodo Sino dhe Pelivan Guraj jane deklaruar nga OE si pllakashtrues, por bazuar ne listepagesat e shoqerise te paraqitura ne SPE per 3 **muajt e fundit** si dhe bazuar ne VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Hodo Sino dhe Pelivan Guraj te deklaruar si pllakashtrues me kod te njejte **7112.03** figuron te jete murator.

**2.2 Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST, pika 2.3.12 të kapacitetit teknik ku kërkohet:** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore tipi C, (Kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, "Për stacionim transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Operatori Ekonomik ka dorëzuar në SPE një leje mjedisore të tipit C, por që emërtimi përshkruar i veprimtarisë nuk përputhet me veprimtarinë e kërkuar nga AK ne kriteret e vecanta te kualifikimit "Për stacionim transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]"

"Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

**3. Operatori ekonomik "Elda - VL" sh.p.k** skualifikohet për arsye se: nuk ka paraqitur ofertë ekonomike si dhe dokumentacionin ligjor, ekonomik-financiar dhe teknik ne permbushje te kriterëve te DST-se.

**4. Operatori ekonomik "Colombo" sh.p.k** skualifikohet për arsye se: Operatori Ekonomik nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktor (dërguar në datë 24.09.2020) për ofertën anomalisht të ulët, në përputhje të nenit 56 të LPP.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: “**Bajrami N**” sh.p.k me adresë: Rruga Elbasan - Xibrakë, NJ.A. Labinot - Fushë, km 13, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **26.765.732,7** (njëzet e gjashtëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tridhjetë e dy presje shtatë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** (pesë) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anulojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 01.10.2020**

**Ankesa nuk ka pasur.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari**

**Irland Sina**